DIGIT-ALB sh.a
Pasqyra e pozicionit financiar
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	921,609,401	931,525,740
Aktivet afatgjata jomateriale	6	1,199,940,307	1,086,561,856
Llogari te tjera te arketueshme	7	116,957,488	93,983,358
Pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	8	45,301,200	5,021,200
Total Aktiveve Afatgjata		**2,283,808,396**	**2,117,092,154**
Aktivet afatshkurtra		-	-
Inventarë	9	168,500,671	266,403,384
Llogari te arketueshme tregetare	10	597,442,607	562,498,723
Llogari te arketueshme te tjera	11	301,118,150	332,826,858
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	1,516,133,817	1,204,833,302
Mjetet monetare ne arke e ne banke	13	61,320,579	55,894,848
Total aktive afatshkurtra		**2,644,515,824**	**2,422,457,115**
Total Aktive		**4,928,324,220**	**4,539,549,269**
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar		230,076,000	230,076,000
Rezerva te tjera		-	-
Rezerva ligjore		23,007,600	23,007,600
Fitime te mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		325,546,620	540,446,993
Total kapitali aksionar	14	**578,630,220**	**793,530,593**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	86,575,784	128,968,686
Tatimi i shtyre mbi fitimin	16	401,240	382,639
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	17	34,521,835	54,508,327
Detyrime te tjera afatgjata		-	-
Total Detyrime afatgjata		**121,498,859**	**183,859,652**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	18	754,106,801	578,400,714
Llogari te pagueshme tregetare	19	1,304,754,421	1,014,316,902
Detyrime tatimore	20	89,827,722	103,852,031
Parapagimet e arketuara	21	5,216,203	-
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	22	1,712,408,690	1,794,402,429
Llogari te pagueshme te tjera	23	361,881,304	71,186,949
Total Detyrime afatshkurtra		**4,228,195,141**	**3,562,159,025**
Totali i detyrimeve		**4,349,694,000**	**3,746,018,677**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**4,928,324,220**	**4,539,549,270**

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

DIGIT-ALB sh.a
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera te pergjithshme
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lek)

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura	24	3,772,395,401	3,665,225,879
Te ardhura te tjera jo operative	25	1,692,026,836	1,242,885,008
Materiale te para dhe te konsumueshme	26	(648,162,086)	(531,226,779)
Shpenzime personeli	27	(204,404,754)	(193,498,810)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	28	(402,288,455)	(207,679,363)
Shpenzime te tjera	29	(3,792,350,599)	(3,375,126,340)
Fitimi operativ		**417,216,343**	**600,579,595**
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	30	(20,321,474)	10,556,535
Total shpenzime financiare		**(20,321,474)**	**10,556,535**
Fitimi para tatimit		**396,894,869**	**611,136,130**
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		(18,601)	(382,639)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(71,329,648)	(70,306,498)
Fitimi i vitit	31	**325,546,620**	**540,446,993**
Te ardhura te tjera te pergjithshme		-	
Totali i te ardhurave te pergjithshme		**325,546,620**	**540,446,993**

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

DIGIT-ALB sh.a

Pasqyra e Fluksit të Parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor2014

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		396,894,869	611,136,130
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		402,288,455	207,679,363
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		(326,373)	(179,140)
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		5,087,193	
Interesa te perllogaritura			-
Shpenzime për interesa		47,932,997	59,394,087
Diferenca konvertimi te parealizuara			4,563,441
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		**851,877,141**	**882,593,881**
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Ndryshimi ne inventar		97,902,713	(60,938,887)
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera		42,934,457	353,660,248
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera		276,502,271	(88,742,187)
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra		(311,300,515)	(72,801,983)
Ndryshimi ne grante dhe te ardhura te shtyra		(101,980,231)	41,084,851
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative		**855,935,835**	**1,054,855,923**
Interesa te paguara		(47,932,997)	(59,394,087)
Tatimi i paguar mbi dividendin		(43,235,760)	
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit		(140,813,306)	(59,931,757)
		(231,982,063)	**(119,325,844)**
Aktivitetet investuese			
Blerje te aktiveve afatgjata material		(181,665,231)	(198,511,460)
Blerje te aktiveve afatgjata jomateriale		(323,445,106)	
Shitje e aktiveve afatgjata material		733,086	8,657,994
Blerje e shoqerise se konrolluar minus parate e arketuara		(40,280,000)	(295,371,913)
Dalja per parapagime per asete		(5,812,840)	-
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues		**(550,470,091)**	**(485,225,379)**
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate agjatgjata		(42,392,902)	16,014,945
(Ripagim)/ te hyra nga hua afatshkrter		175,706,087	(194,227,244)
Dividendë paguar		(201,371,134)	(335,389,460)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues		**(68,057,949)**	**(513,601,759)**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**5,425,731**	**(63,297,059)**
Mjetet monetare ne fillim te periudhës		55,894,848	119,191,907
Mjetet monetare ne fund te periudhës		**61,320,579**	**55,894,848**

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

DIGITALB
www.digitalb.al

DIGIT-ALB sh.a

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura /humbje te akumuluara	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	**230,076,000**	**95,995,073**	**25,481,927**	-	**236,920,060**	**588,473,060**
Pakesim i rezervave ligjore		2,474,327	(2,474,327)			-
Dividendë te paguar		(98,469,400)			(236,920,060)	(335,389,460)
Fitimi i vitit					540,446,993	540,446,993
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	-	-
31 Dhjetor 2013	**230,076,000**	-	**23,007,600**	-	**540,446,993**	**793,530,593**
Pakesim i rezervave ligjore						
Dividendë te paguar					(540,446,993)	**(540,446,993)**
Fitimi i vitit					325,546,620	325,546,620
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse:						-
31 Dhjetor 2014	**230,076,000**	-	**23,007,600**	-	**325,546,620**	**578,630,220**

Shënimet shpjeguese të faqeve 6 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues me 20 Mars 2015 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Z. Alban Jaho
Administrator

Teuta Vrushi

Pergatitur nga:
Znj. Teuta Vrushi

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DIGIT-ALB sh.a ("Shoqeria") është krijuar juridikisht më 23.04.2004, regjistruar më 18.05.2004 ne QKR. Me 31 dhjetor 2014 pronësia e kapitalit zotërohet nga disa aksionerë.
Kapitali i shoqerise është 230.076.000 lekë, i barabartë 1.800.000 euro i ndarë në 960.000 aksione.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte ndertimi, tregetimi i sistemeve te telekomunikacioneve, prodhimi i sherbimeve audio dhe video.

Perfaqesues Ligjor i shoqerise eshte Z.Alban Jaho.
Shoqeria drejtohet nga Keshilli Mbikqyres i cili perbehet nga :

- Petraq Shomo
- Enkelejdi Joti
- Eduard Poda
- Arben Taipi
- Albert Sino
- Ilir Karaguni
- Niko Leka

Selia e shoqerise ndodhet ne Rrugen "Pavaresia", Nr 39, Kashar, Tirane.
Kompania eshte rregjistruar ne Drejtorine Rajonale te Tatim Paguesve te Medhenj Tirane me NIPT K41719004D
Shoqeria me 31 Dhjetor 2014 kishte 328 punonjes te rregjistruar (31 Dhjetor 2013: 309).

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive ne periudhen aktuale

Standardet dhe interpretimet e meposhtme jane bere efektive prej 1 Janarit 2014:

Amendimi ne SNRF 32, "Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare" (publikuar ne Dhjetor 2011 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Amendimi ka shtuar udhezime aplikimi per SNK 32 i cili adreson mosperputhjet e identifikuara ne aplikimin e disa prej kritereve te kompensimit. Kjo përfshin qartësimin e paragrafit "momentalisht ka nje te drejte te detyruar me ligj per kompensim" dhe qe disa sisteme te shlyerjes bruto mund te konsiderohen si ekuvalente te shlyerjeve neto. Standardi sqaroi se nje e drejte per komensim (a) nuk duhet te kushtëzohen nga ngjarje ne te ardhmen dhe (b) duhet te jete i detyrueshëm ligjërisht ne te gjitha rrethanat ne vijim: (i) ne rrjedhën normale te biznesit, (ii) ne rast mosfunskionimi dhe (iii) ne rast falimentimi. Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne SNRF 10, SNRF 12, SNK 27 "Njesite ekonomike Investuese" (publikuar ne 31 Tetor 2012 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne KIRFN 21, "Taksat" (publikuar ne 20 Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne SNRF 36, "Dhenia e informacionit mbi shumat e rikuperueshme per aktivet jo-financiare" (publikuar ne Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014; aplikimi i meparshem eshte i lejuar nqs eshte aplikuar SNRF 13 per periudhen kontabel dhe periudhen krahasuese). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

2. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)

Amendimi ne SNRF 39, "Zevendesimi I Derivateve dhe vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtes" (publikuar ne Qershor 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te pa pervetesuara

Ne daten e aprovimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e meposhtme, interpretimet dhe rishikimet jane emetuar por nuk jane ende efektive:

- *SNRF 9 "Instrumentat financiare: klasifikimi dhe matja" (publikuar ne Korrik 2014 dhe efektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2018).*
- *Amendime ne SNK 19 – "Skemat e perfitimeve te percaktuara: Kontributet e punonjesve" (publikuar ne Nentor 2013 dhe efektiv per periudhat qe fillojme me 1 Korrik 2014).*
- *Permiresimet vjetore per SNRF-te 2012 (publikuar ne Dhjetor 2013 dhe efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Korrik 2014, pervec kur shprehet ndryshe me poshte).*
- *Permiresimet vjetore per SNRF-te 2013 (publikuar ne Dhjetor 2013 dhe efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Korrik 2014).*
- *SNRF 14, Llogarite rregullatore e shtyrjes (publikuar ne Janar 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).*
- *Kontabilizimi per blerjet e interesave ne Operacionet e Perbashketa – Amendime ne SNRF 11 (publikuar me 6 Mah 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).*
- *Qartesimi i metodave te pranueshme per Amortizimin dhe Zhvleresimin – Amendime ne SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar me 12 Maj 2014 dhe edektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).*
- *SNRF 15, Te ardhurat nga Kontratat me Klientet (publikuar me 28 Maj 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 janar 2017).*
- *Bujqesi: Bimet Prodhuese – Amendime ne SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar me 30 Qershor 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me 1 Janar 2016).*
- *Metoda e kapitalit ne pasqyrat financiare individuale – Amendimet ne SNK 27 (publikuar me 12 Gusht 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me 1 Janar 2016).*
- *Shitje ose Kontribut ne asete midis nje Inestitori dhe bashkepunetorit te tij ose sipermarrjes se perbashket – Amnedime ne SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar me 11 Shtator 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).*
- *Permiresimet vjetore per SNRF-te 2014 (emet publikuar uar ne 25 Shtator 2014 dhe efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).*
- *Dhenia e informacioneve shpjeguese sipas Amendimeve te SNK 1 (publikuar ne Dhjetor 2014 dhe efektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).*
- *Njesite ekonomike investuese: Aplikimi i Perjashtimit te Konsolidimit amendim ne SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar ne Dhjetor 2014 dhe efektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).*

Kompania ka zgjedhur te mos i pervetesoje keto standarde, rishikime dhe interpretime para dates qe ato do te behen efektive. Kompania parashikon se pervetesimi i ketyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te kete ndikim material ne pasqyrat financiare te kompanise ne periudhen e aplikimit fillestar te tyre.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

3. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti per Interpretimet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.
Ne vitin 2013 eshte krijuar dega e Kosoves. Pasqyrat financiare jane paraqitur te konsoliduara per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2014 duke perfshitre edhe degen e Kosoves.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Bazat e Konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, qe në përgjithësi u atribuohen aksionereve qe zoterojne më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur eshte bere vleresimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjeter ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht qe nga data në të cilën kontrolli i eshte transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për te kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur ne vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna , instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuara ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte te blerjes. Aktivet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqerive te grupit, balancat dhe fitimet e parealizuara për transaksione ndërmjet shoqerive te grupit janë eliminuar. Gjithashtu jane eleminuar humbjet e parealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qene e nevojshme per t'u perputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

(a) Te ardhurat

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlere te drejte te shperblimit te mare per sherbimin e kryer, neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Zërat jo monetare maten në bazë të kostos historike dhe nuk konvertohen në datën e raportimit.

Diferencat nga kursi i këmbimit nga zërat monetarë, njihen në fitim ose humbje të periudhës të cilës i përkasin.

Fitimi dhe humbja nga monedha e huaj, raportohen në baza neto.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Euro	140.14	140.20
USD	115.23	101.86
CHF	116.52	114.41
GBP	179.48	168.39

(c) Instrumenta financiarë

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit. Fillimisht Shoqëria i regjistron aktivet dhe detyrimet financiare me vlerë e drejtë. Matja e mëvonshme për secilin intrument financiar, është e detajuar në shënimet e mëposhtme.

Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhën e parasë nga aktivi skadojnë ose në qoftë se transferon të drejtat për të arkëtuar flukset kontraktuale të parasë të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që është krijuar apo përfituar prej Shoqërisë njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe vlera neto e tyre paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të kompesuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentat financiare jo derivative të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, detyrimet tregtare dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat maturimi me më pak se tre muaj.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera
Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë matur me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë
Huate jane njohur fillimisht me vleren e drejte, neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, me shpenzime interesi te njohura bazuar ne normen efektive.
Metoda e interesit efektiv eshte metoda e llogaritjes te kostos se amortizuar te detyrimit financiar dhe e alokimit te shpenzimit te interesit pergjate periudhes perkatese. Norma efektive e interesit eshte norma qe skonton saktesisht vlerat e ardhshme te parave pergjate jetegjatesise se planifikuar te detyrimit financiar ose, kur eshte e pershtatshme, per nje periudhe me te shkurter vleren e mbetur neto nga njohja fillestare.

(d) Inventaret

Inventare njihen me me te voglen mes kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kosot jane ato shpenzime te kryera per te sjelle cdo produkt ne vendndodhjen dhe kushtet aktuale deh percaktohen ne baze te kostos mesatare te ponderuar.
Vlera neto e realizueshme bazohet ne cmimin e vleresuar te shitjes minus cdo kosto qe pritet te ndodhe ne perfundim apo ne nxjerrjen jashte perdorimit.

(e) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja
Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur.
Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Ndertesa	5%
Mobilje dhe orendi	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Makineri dhe pajisje	20%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen per zhvleresim kur ngjarje apo ndryshime ne rrethanat tregojne se vlera kontabel mund te mos jete e rikuperueshme. Nese ekziston ndonje tregues i tille, kur vlera kontabel tejkalon vleren e rikuperueshme te vleresuar aktivet paraqiten me vleren e tyre te rikuperueshme, e cila eshte me e larta mes vleres se tyre te drejte minus kostot per shitje dhe vleres se tyre ne perdorim.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes që nuk janë në funksionim.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo date raportimi dhe ndryshohen ne rast se efektet jane materiale.

Çregjistrimi

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Aktivet Afagjtata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:
është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe
kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Mbajtja e mepasshme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvelrësimi.

Aktivet jo-materiale amortizohen me normen 15% mbi koston historike.

(f) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

(g) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar jo i mbartur me vlerë të drejtë nëpermjet fitimit dhe humbjes është vlerësuar në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe ka patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Humbjet janë njohur në të ardhura dhe shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet skontimit te qendrueshem. Kur një ngjarje e ardhshme (p.sh. shlyerja e një debitori) shkakton një rënie në shumën e humbjes nga zhvlerësimi, rënia në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(i) Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.
Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

(h) Provigjonet

Një provigjon njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(i) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiratë e zakonshme janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Lehtësirat e përfituara të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

(j) Llogarite e pagueshme dhe te shtyrat

Detyrimet njihen per shumat te cilat duhet te paguhen ne te ardhmen per te mirat dhe sherbimet e perfituara, qofte te faturuara nga furnizuesi apo jo.

(k) Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten ne pasqyren e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur ne Pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera te pergjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale pergjat jetës së dobishme të aktivit.

(l) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

(m) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare.

(n) Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfaredolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme. Normat e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 dhe 2013 paraqiten me poshte:

	Viti 2014	Viti 2013
Perqindja e Tatimit mbi Fitimin	15%	10%

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digitalb.al

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(o) Tatimi i shtyre mbi fitimin

Tatimi i shtyre eshte siguruar duke perdorur metoden e detyrimeve, mbi te gjitha diferencat e perkohshme ne daten e raportimit midis bazes tatimore te aktiveve dhe detyrimeve dhe vleres se tyre kontabel. Tatim fitimi i shtyre aktiv dhe pasiv matet me normat tatimore qe pritet te zbatohen per periudhen kur aktivi realizohet ose detyrimi shlyhet, i bazuar ne legjislacion in ne fuqi ne daten e raportimit.

